



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 244/14

Nr. i fq. / Br. sh - 9 -

Data: / Datum 27.11.2014

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E X-TË E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISE,
MBAJTUR MË 30 TETOR 2014**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:12.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:
Agim Bregaj, Agron Perquku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakic.

Mungoi: Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - propozoi që në “të ndryshme” të futet edhe shqyrtimi i propozimit të LDK-së për anëtarin e Komitetit për Komunitete.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit - duke iu referuar pikës nr. 2 të rendit të ditës, tha se neni 92.2 i Statutit të Komunës thotë: “propozimi për ndryshimin e statutit duhet të dërgohet tek Kuvendi i komunës për shqyrtim fillestar. Kuvendi i komunës para shqyrtimit final duhet të konsultojë publikun në lidhje me atë propozim”. Kurse neni 92.3 thotë: “pas përfundimit të periudhës së konsultimit, Kuvendi i komunës duhet të vendosë se a do ta miratojë statutin me ndryshime pas shqyrtimit të të gjitha vërejtjeve të marra”, prandaj duke e bazuar nevojën për shqyrtim dhe diskutim me publikun kërkoi që jo vetëm të shtyhet pika nr. 2 e rendit të ditës, por kërkoi që të mos sillet për shqyrtim final pa pasur një program që do të shqyrtohej dhe konsultohet publiku, pasi që nëse ndodh kjo do të ketë grupe të interesit, qytetarë dhe pjesëtarë të shoqërisë civile, të cilët janë të interesuar të japin kontributin e tyre për ta pasuruar dhe plotësuar draft-statutin e komunës. Po ashtu tha se arsye e këtij propozimi për shtyrje të shqyrtimit të draft-statutit në fjalë, është fakti se anëtarët e Kuvendit të komunës në kundërshtim me afatet e Rregullores së Punës së Kuvendit, Statutit të Komunës dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, këtë draft-statut e kanë marrë vetëm para tre (3) ditësh dhe nuk ka asnjë informacion se ku janë mbajtur takimet me publikun, nuk ka procesverbal të atyre

takimeve, si dhe nuk ka të evidentuara as propozime dhe sugjerime, të cilat janë dhënë, futur apo hequr në draft-statutin në fjalë. Në fund tha se po synohet formimi edhe i dy drejtorive që si rezultat i mosveprimeve të cilat i përmendi më lartë nuk dihet arsyeja e vërtetë, kostoja dhe nevoja e formimit të këtyre drejtorive apo ndoshta është vepruar në mënyrë të shpejtuar nga disa anëtarë të komisionit, me qëllim të akomodimit të dikujt në vende udhëheqëse, ndërkaq shtoi se nëse ka kushte për diskutim publik real, atëherë ndoshta do të vijë në shprehje zvogëlimi i numrit të drejtorive e jo rritja e numrit të tyre, prandaj propozoi që pika nr. 2 e rendit të ditës të shtyhet me të vetmin qëllim të diskutimit të mëtutjeshëm dhe marrjes së propozimeve të reja, të cilat do të shërbejnë për funksionim sa më të mirë të institucioneve komunale në harmoni me ligjin dhe në interesin e qytetarëve të komunës sonë.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të LDK-së e dënoi ashpër dhunën e djeshme të ushtruar ndaj punëtorit të komunës Mexhit Hasanit, dhe kërkoi që kryerësit e veprës të dënohen në bazë të ligjit. Kurse sa i përket rendit të ditës, tha se duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit, në nenin 18, pika 18.1 thuhet: “para se të paraqiten në Kuvend, çështjet duhet të shqyrtohen nga kryetari i komunës dhe Komiteti për Politikë dhe Financa”, prandaj pika nr. 2 e rendit të ditës nuk ka qenë fare për shqyrtim në KPF dhe për këtë arsye në emër të Grupit kuvendar të LDK-së kërkoi që pika nr. 2 e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen tjetër të Kuvendit të komunës. Në fund tha se me nenin 3.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, thuhet: “anëtarët e kuvendit pajisen me kartelë identifikimi më së largu 30 ditë pas verifikimit të mandatit të tyre”, prandaj kërkoi nga administrata e komunës që sa më parë të përgatitë kartelat e identifikimit për anëtarët e kuvendit.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - lidhur me pikën nr. 2 të rendit të ditës, sqaroi se në muajin janar të këtij viti, është formuar komisioni nga Kuvendi i komunës, për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës, pastaj Statuti i Komunës ka qenë edhe në diskutim publik dhe e njëjta pikë nuk shqyrtohet dy herë në KPF, pasi që njëherë është shqyrtuar në KPF. Në fund njoftoi se javën e kaluar ka kërkuar nga zyrtari kompetent përgatitjen e kartelave të identifikimit për anëtarët e Kuvendit të komunës.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 21 vota “për” 10 “kundër”, të tjera “abstenim”, miratoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Draft-Statutit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).
3. Shqyrtimi i Propozim-Skemës (Organogramit) të Komunës së Vushtrrisë.
4. Shqyrtimi i Draft-Statutit të Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).
5. Shqyrtimi i Raportit për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt: korrik, gusht dhe shtator.
6. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen shëndetësore të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me nivelin e pastërtisë së qytetit dhe eliminimit të deponive ilegale të mbeturinave.
8. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të KK-së Nr.24/14 të datës 30.01.2014.
9. Shqyrtimi i Kërkesës për harmonizimin e listës së subvencioneve.
10. Të ndryshme:
 - a. Shqyrtimi i propozimit nga LDK-ja për anëtar të Komitetit për Komunitete.
 - b. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - tha se në procesverbal është një lëshim i vogël teknik, pasi që tek pjesëmarrja në mbledhje ceket se ka qenë prezente edhe Syzana Sylja, kurse e njëjta ka munguar në mbledhjen paraprake.

Aprovohet më 24 vota “për” të tjerat “abstenim” procesverbali në fjalë, me vërejtjen e M. Selacit.

2. Shqyrtimi i Draft-Statutit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - duke iu referuar draft-statutit në fjalë, tha se Grupi kuvendar i LVV-së fillimisht e ka përkrahur, sepse edhe kjo lëvizje e ka pasur në alternativën e vet qeverisëse lokale, krijimin e Drejtorisë së Bujqësisë si drejtori e veçantë, pasi që është më se e nevojshme duke e ditur që komuna jonë e ka mjaft të zhvilluar këtë sektor, mirëpo duke parë që në qëllimin e autoriteteve komunale nuk është në epiqendër interesi për të përkrahur Sektorin e bujqësisë, por vetëm akomodimi i partnerëve politikë të pushtetit aktual, të cilët dolën nga marrëveshja e fshehtë para zgjedhjeve parlamentare, e që ende nuk po e dinë se cilit subjekt politik i takojnë, si dhe duke parë joseriozitetin në propozimin edhe të drejtorive tjera, që në total arrijnë numrin katërbëdhjetë (14) drejtori, përkundër faktit se komuna jonë nuk posedon kapacitet për të përballuar një gjë të tillë, prandaj LVV-ja kundërshton krijimin e drejtorive të reja, që do të shërbenin për përmbushjen e apetiteve të klaneve partiake, në vend të politikave të reja zhvillimore.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - duke iu referuar draft-statutit në fjalë, tha se për Grupin kuvendar të LDK-së është i pajustificueshëm krijimi i tri drejtorive të reja, duke shtuar se nëse rritja e drejtorive nuk sjellë ndonjë ekspertizë jashtë komunës dhe nuk mund të përmirësohet performanca e komunës, si dhe jeta e qytetarëve të komunës sonë, atëherë pse të rriten shpenzimet në komunën tonë. Pastaj tha se as me buxhetin komunal për vitin 2015 nuk është paraparë formimi i drejtorive të reja. Në vazhdim përmendi disa komuna të cilat kanë numër më të vogël të drejtorive sesa Komuna e Vushtrrisë. Në fund tha se për Grupin kuvendar të LDK-së është e papranueshme rritja e numrit të drejtorive.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar draft-statutit në fjalë, në emër të Grupit kuvendar të PDK-së, propozoi që nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, të formohet drejtoria e re e quajtur Drejtoria për Përkujdesje Sociale, duke pasur parasysh problemet e mëdha sociale, volumin e punëve dhe numrin e stafit punonjës, si dhe nevojën e krijimit të politikave të mirëfillta sociale.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - duke iu referuar draft-statutit në fjalë, tha se ka qenë kërkesë dhe është potencuar vazhdimisht nga opozita, si dhe nga kryetari i komunës nevoja e krijimit të Drejtorisë për Bujqësi, duke shtuar se Komuna e Vushtrrisë identifikohet me bujqësinë, prandaj është vlerësuar e nevojshme që të ketë një drejtori të veçantë, e cila trajton vetëm çështjet e bujqësisë. Pastaj tha se për një menaxhim më të mirë të pronave komunale, ka propozuar që të jetë drejtori e veçantë Drejtoria për Çështje Pronësore Juridike. Në vazhdim tha se janë paraqitur edhe propozime të tjera për formimin e drejtorive të reja, por nuk janë bërë analiza të mirëfillta të implikimeve buxhetore për këto propozime. Pastaj duke iu referuar propozimeve për drejtori të reja, të paraqitura nga komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës, tha se është bërë një shkelje, pasi që së pari është dashtë të prezantohet propozimi i kryetarit të komunës (e që nuk është paraqitur fare në mbledhjen e Kuvendit të komunës), pastaj të prezantohet propozimi i komisionit në fjalë. Mandej tha se

është diskutabile përfshirja dhe emërtimi i drejtorive të ekzekutivit të komunës në Statutin e komunës, pasi që kompetencat e ekzekutivit të komunës dhe të legjislativit janë të ndara prej njëra tjetrës edhe në bazë të legjislacionit në fuqi. Në fund lidhur me propozimet për krijimin e drejtorive të reja, tha se është problem për të ndodhur një gjë e tillë edhe për shkak të numrit të limituar të punëtorëve në administratën e komunës, prandaj propozoi që pika nr. 2 e rendit të ditës të hiqet nga rendi i ditës për t'u analizuar më gjatë dhe më mirë për t'u proceduar në njërën nga mbledhjet e radhës së Kuvendit.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar propozimeve për krijimin e drejtorive të reja, kërkoi që të mendohet më gjatë dhe më arsyeshëm nga anëtarët e kuvendit, duke vlerësuar interesin e përgjithshëm të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Në fund tha se pasi që ka disponim për shtyrje nga një pjesë e anëtarëve të kuvendit, në emër të Grupit kuvendar të PDK-së propozoi që draft-statuti në fjalë të shtyhet për mbledhjen tjetër të Kuvendit.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha, së pari që të gjitha grupet kuvendare kërkuan shtyrjen e kësaj pike të rendit të ditës, dhe pasi që u dhanë vërejtje lidhur me mënyrën e organizimit të diskutimit publik, propozoi që i njëjti dokument së bashku me propozimet e paraqitura të procedohet për diskutim publik.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - tha se nuk do të votojë asnjëherë në Kuvend diçka që nuk është e ligjshme, prandaj është mirë që po shtyhet aprovimi i ndryshimit të draft-statutit në fjalë, prandaj kërkoi që ndryshimet të koordinohen me kryetarin e komunës dhe ndryshimet të bëhen në përputhshmëri me ligjin.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - tha se çdo anëtar i kuvendit është i angazhuar për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke shtuar se draft-statuti në fjalë është proceduar në Kuvend, duke respektuar ligjin, pasi që i ka kaluar të gjitha fazat e nevojshme për t'u shqyrtuar në mbledhjen e Kuvendit të komunës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 31 vota “për”, 1 “kundër”, vendosi me sa vijon:

Jepet në diskutim publik Draft-Statuti për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë.

Diskutimi publik fillon nga data 31 tetor 2014 dhe zgjat deri më 18 nëntor 2014.

3. Shqyrtimi i Propozim-Skemës (Organogramit) të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk u diskutua dhe nuk u votua, pasi që pika nr. 2 e rendit të ditës (e cila ka lidhshmëri me këtë pikë të rendit të ditës) shkoi përsëri në diskutim publik.

4. Shqyrtimi i Draft-Statutit të Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).

Agron Perquku, anëtar i kuvendit - duke iu referuar draft-statutit në fjalë, tha se është e nevojshme që të amandamentohet paragrafi 4.2 dhe të ceket edhe viti i themelimit të teatrit, dhe shtoi se Teatri i Qytetit të Vushtrrisë ekziston nga viti 1971, i cili ka funksionuar si teatër amator. Te neni 14 propozoi të shtohet paragraf i ri me këtë përmbajtje: “drejtori i teatrit harton planin e punës dhe raporton për punën e bërë, dhe i njëjti duhet të rekomandojë për çdo vit për miratim në Kuvend”.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - duke iu referuar draft-statutit në fjalë, paraqiti këto vërejtje dhe propozime: së pari pyeti se a mund të ketë teatri i qytetit xhirollogari të veten, pasi që në draft-statutin në fjalë thuhet se burimet financiare për funksionimin e teatrit i siguron komuna; nga neni 12 kërkoi që të hiqet pika 9, meqë kjo krijon konflikt interesi, pasi që nëse projektet shqyrtohen në këshillin drejtues, gjithmonë do të fitojë projekti në të cilin

merr pjesë si aktor anëtar i këshillit drejtues; tek neni 15 kërkoi që të hiqet 1.11, pasi që pyeti se si mund t'i shmanget konfliktit të interesit nëse i lejohet të luajë në shfaqje dhe në të njëjtën kohë të bëjë regjinë.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - tha se është i kënaqur që më në fund organet komunale po e rregullojnë çështjen e teatrit të qytetit tonë, duke e pasur parasysh kontributin e dhënë vullnetarisht nga secili, duke filluar nga regjisorët, skenografët dhe sidomos të aktorëve të të gjitha moshave, të cilët me dekada të tëra punuan vullnetarisht që ta mbajnë gjallë skenën vushtrriase, prandaj shpresoj që tani e tutje do ta kenë më të lehtë punën dhe do t'ju shpërblehet munda më shumë. Pastaj kërkoi që pas aprovimit të draft-statutit në fjalë, të mos lihen anash aktorët lokal, pasi që dihet se përzgjedhja e aktorëve për shfaqje do të bëhet me audienca dhe se në këto audienca mund të marrin pjesë edhe aktorë nga qytete tjera, sepse është e papranueshme që të mos ndodh që tani pasi që aktorët do të paguhen, të anashkalohej aktorët tonë nga ndonjë individ i caktuar, por kërkoi që të njëjtit të kenë përparësi, pasi që zakonisht ndodhin anashkalime dhe përmendi rastin e moderimit të takimit të poeteshave shqiptare, në ç'rast janë angazhuar moderatorë jashtë Komunes së Vushtrrisë, e jo vushtrriasit, të cilët moderojnë të gjitha organizimet tjera pa të holla.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - lidhur me draft-statutin në fjalë, tha se te neni 12, pika 5, duhet të precizohet se a bëhet fjalë për seancën e Kuvendit të komunës apo për seancën e Këshillit drejtues të teatrit, po ashtu duhet të precizohet se kush e udhëheq takimin e parë të këshillit drejtues, duke shtuar se logjikisht është e mirë që këtë takim të parë ta udhëheq anëtar i më i vjetër i këshillit.

Shpresa Rama, drejtoreshë e DKRS-së - paraqiti sqarime shtesë lidhur me pyetjet, vërejtjet dhe propozimet e bëra nga anëtarët e kuvendit, lidhur me draft-statutin në fjalë.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - pyeti se cili është implikimi financiar për teatrin e qytetit, kur dihet që ka nevoja dhe kërkesa të shumta, dhe fondi për aktivitete kulturore është më i madh sesa fondi për kategoritë me nevoja sociale apo subvencione.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - sqaroi se nuk ka ndonjë specifikim lidhur me implikimet buxhetore për teatrin e qytetit, por Vushtrria e meriton ta ketë teatrin e vet, si dhe shtoi se teatri i qytetit mund të sigurojë financa edhe përmes aplikimit në projekte të ndryshme.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit - tha se me draft-statutin në fjalë po zyrtarizohet puna shumëvjeçare e teatrit dhe nuk po hedhet mbrapa angazhimi prej shumë vitesh. Në fund tha se nuk është krahasim adekuat çështja e kulturës me çështjen e rasteve sociale.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 26 vota "për", të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:

Aprovohet Statuti i Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë, duke inkorporuar propozimet e anëtarëve të kuvendit, të cilat janë në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.

5. Shqyrtimi i Raportit për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt: korrik, gusht dhe shtator.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - tha se raporti në fjalë flet qartë për një njësi buxhetore shpenzuese dhe shtoi se në këtë raport ka gabime terminologjike, pasi që nuk thuhet "taksa në firmë" por duhet thënë "taksa në ushtrimin e veprimtarisë". Pastaj tha se kur bëhet fjalë për taksën në firmë, shprehu brengën e Grupit kuvendar të LDK-së, pasi që kjo taksë është rekomanduar nga USAID-i që të hiqet nga planifikimi i të hyrave vetanake komunale, kurse komuna trumbeton se po krijon ambient të favorshëm për të bërë biznes, ndërkaq në praktikë e bën të kundërtën, duke vjelë taksën jo të preferuar nga përkrahësit e zhvillimit të ambientit ndërmarrës në komunën tonë. Po ashtu në raportin në fjalë lidhur me tatimin në pronë dhe taksën në ushtrimin e veprimtarisë nuk ekziston edhe informata sesa nga këto të hyra të

realizuara janë detyrime nga vitet e mëparshme, prandaj është e nevojshme që të paraqitet një tabelë, në të cilën do të specifikohen se cilave vite iu takojnë këto të hyra. Në vazhdim pyeti se çfarë nënkuptohet për menaxhmentin e komunës transaksionet 16,865.80 €, si dhe çfarë analize ka bërë për këtë kategori Sektori i zhvillimit ekonomik, prandaj në emër të Grupit kuvendar të LDK-së kërkoi për mbledhjen e ardhshme të KK-së një analizë të hollësishme të kësaj çështjeje, të shoqëruar me rekomandime të përcaktuara në kohë dhe në bartës të aktiviteteve. Mandej tha se rezultate të mira në realizimin e të hyrave shihet se ka tek Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, duke uruar që kjo të mos duket kështu vetëm në saje të planifikimit joreal, por në saje të aktivitetit të drejtorisë. Ndërsa të hyrat në Sektorin e kulturës janë të realizuara vetëm 42 %; kurse brengosëse është që Drejtoria për Prokurim nuk ka shqiptuar asnjë gjobë penale, prandaj kërkoi sqarim pse kjo po ndodh pothuajse çdo vit. Gjithashtu tha se është shqetësuese përqindja e inkasimit nga qiraja e tokës bujqësore, prandaj pyeti se cilat masa do t'i ndërmer komuna për përmbushjen e objektivave, si dhe pyeti a ka bërë komuna ndonjë analizë meritore pse është kaq e ulët shkalla e donacioneve të brendshme. Tutje tha se raporti në fjalë vë në pah se 80 % të të hyrave vetanake janë realizuar, por nuk tregon se sa prej tyre janë llogari të arkëtueshme nga vitet e kaluara, si dhe shtoi se shpenzimet tek të gjitha kategoritë po vijojnë mirë, por nuk po vijojnë mirë burimet vetanake të financimit. Në fund tha se në raport shihet mungesa e strategjisë së komunës drejt krijimit të partneritetit frytdhënës me komunitetin e biznesit, duke shtuar se nuk ka asnjë të hyrë komunale nga partneriteti publiko-privat, madje nuk janë hedhur as hapat e parë drejt këtij trendi.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit - tha se raporti në fjalë ka shumë gabime drejtshkrimore, prandaj kërkoi që në të ardhmen dokumentet fillimisht të lekturohen, e pastaj të procedohen për Kuvend.

6. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen shëndetësore të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit - duke iu referuar informatës në fjalë, tha se në komunën tonë janë kontrolluar, ekzaminuar dhe janë kryer 66517 vizita mjekësore, kurse participimi ka qenë vetëm nga 23046 raste, prandaj kjo shifër e participimit është alarmante, pasi që ngarkon buxhetin e stërngarkuar në komunë. Pastaj tha se shërbimi i vaksinimit është në proces në shumë vendbanime dhe lokalitete të komunës sonë, ku kujdes të veçantë meriton t'i kushtohet nxënësve të klasës së I-rë dhe të II-të dhe nxënësve të klasave VI-të dhe VII-të. Po ashtu vëmendje të veçantë duhet kushtuar sëmundjeve infektive, me theks të veçantë sëmundjeve të mushkërive. Në fund ftoi opinionin dhe popullatën që me të gjitha mundësitë dhe mjetet që disponojnë të na përkrahin në luftën për një shëndet më të mirë, jetë të qetë dhe të rehatshme.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - paraqiti një ankesë të banorëve të fshatrave për mosrespektimin e orarit të punës nëpër ambulanta.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar informatës në fjalë, tha se është shqetësues numri i rasteve të reja të TBC-së për këtë periudhë kohore. Pastaj lidhur me participimin, tha se shumë kategori janë të liruara nga participimi, prandaj duke e vlerësuar gjendjen e rëndë sociale, nuk duhet pritur rritje të të hyrave nga shëndetësia. Po ashtu tha se është brengosëse për mënyrën e furnizimit me barëra të qytetarëve tonë nëpër barnatoret private, duke shtuar se akoma nëpër këto barnatore qytetarët marrin barëra pa receta, edhe pse kjo çështje është kompetencë e Inspektoratit të Ministrisë së Shëndetësisë. Mandej tha se barnatoret private janë të obliguara që ta mbajnë kujdestarinë një herë në javë. Në fund pyeti se a bëhet prezantimi i sëmundjeve akute infektive nga ana e ordinancave private, dhe shtoi se prezantimi nuk është real, pasi që ka shumë raste me Hepatit B dhe C dhe burimi i tyre vjen nga ordinancat private, sidomos atyre stomatologjike.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar informatës në fjalë, tha se janë shqetësuese rastet me Hepatit, dhe kjo vjen si pasojë e nivelit jo të mirë të higjienës në klinikat private stomatologjike, prandaj kërkoi nga kryetari i komunës që të merren masa që përmes inspektoratit të monitorohet niveli i pastërtisë. Në fund tha se në Kuvendin e komunës është miratuar shërbimi stomatologjik në 24 orë në ditë, prandaj pyeti pse nuk po zbatohet ky vendim?

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit - tha se ekipi i mjekëve që ka filluar kontrollin sistematik të nxënësve nëpër shkolla, duhet që në të njëjtën kohë t'i pajisin nxënësit me barëra, për shkak të rasteve të shumta të nxënësve me morra, sidomos në shkollën A.Z. Çajupi.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - tha se informata në fjalë është hartuar në mënyrë të mirë, dhe kërkoi që në të ardhmen të bëhet krahasimi në mes të viteve, për të vlerësuar gjendjen shëndetësore të qytetarëve të komunës sonë, dhe nëse ka përkeqësim të shëndetit të cekën shkaktarët e përkeqësimit. Në fund pyeti pse është reduktuar orari i punës së mjekëve nëpër ambulanta të fshatrave?

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHPS-së - paraqiti sqarime shtesë lidhur me pyetjet, vërejtjet dhe propozimet e bëra nga anëtarët e kuvendit lidhur me informatën në fjalë.

7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me nivelin e pastërtisë së qytetit dhe eliminimit të deponive ilegale të mbeturinave.

Zoran Rakic, anëtar i kuvendit - së pari foli për themelimin e teatrit të qytetit dhe shprehu dëshirën e tij që në të ardhmen të ketë sa më shumë aktivitete rinore dhe kulturore. Kurse lidhur me informatën në fjalë, tha se përfaqësuesit e Zyrës për Kthim dhe Komunitete kanë pasur takim me përfaqësuesit e kompanisë së mbeturinave "Uniteti" pasi që kanë probleme me transportin e mbeturinave dhe banorët e fshatit Prelluzhë ia kanë borxh 15.000 € kompanisë, dhe shtoi se kompania në fjalë nuk ka bërë asnjë marrëveshje me banorët e fshatit Prelluzhë. Mandej kërkoi nga kryetari i komunës dhe inspeksioni që të merren masa që të ndëshkohen ata që hedhin mbeturina në vende të ndaluara për hedhjen e tyre. Në vazhdim tha se edhe pse një numër i vogël i banorëve të fshatit Prelluzhë kanë paguar obligimet ndaj kompanisë "Uniteti". Kjo kompani nuk është e interesuar që ta pastrojë fshatin Prelluzhë, prandaj pyeti kryetarin e komunës se a mundet fshati Prelluzhë ta kontraktojë një kompani tjetër nga Komuna e Obiliqit për menaxhimin e mbeturinave të fshatit në fjalë. Në fund paraqiti një vërejtje për drejtorët e drejtorive që nuk po iu përgjigjen ftesave të Komitetit për Komunitete për pjesëmarrje në mbledhjet e këtij komiteti.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - lidhur me informatën në fjalë, tha se nuk po bëhet në mënyrë të duhur menaxhimi i mbeturinave, duke shtuar se çështja e menaxhimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së ambientit është problem përveç nivelit lokal edhe në nivelin qendror. Pastaj tha se ka menduar që një prej formave të përmirësimit të menaxhimit të mbeturinave është që kompania "Uniteti" ta marrë statusin e kompanisë komunale, pasi që e meta e madhe e kësaj kompanie është që zyrtarët e saj nuk po punojnë edhe përkundër realizimit të të hyrave të konsiderueshme. Në vazhdim tha se Komuna e Vushtrrisë i ka ofruar bashkëpunim të vazhdueshëm kompanisë "Uniteti", si dhe iu ka dhënë propozime të ndryshme, por përsëri kompania nuk ka vepruar dhe nuk ka punuar. Ndërsa lidhur me pyetjen e Z. Rakicit, tha se duhet të konsultohet Zyra Ligjore se a lejohet kontraktimi i një kompanie nga komuna tjetër për të kryer shërbimet e caktuara në fshatin Prelluzhë, dhe shtoi se banorët e fshatit Prelluzhë nuk i kanë borxh kompanisë "Uniteti", pasi që kompania në fjalë nuk ka kryer asnjë shërbim në këtë fshat, prandaj është shumë i qëlluar propozimi i komunës që kompania në fjalë të lidhë kontratë me çdo familje (shtëpi). Gjithashtu tha se drejtorët e drejtorive duhet t'i përgjigjen ftesave për pjesëmarrje në mbledhjet e Komitetit për Komunitete.

8. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të KK-së Nr.24/14 të datës 30.01.2014.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i KK-së 01Nr.24/14, dt. 30.01.2014, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si vijon: në nënparagrafin 1.1., nënpika 6, në vend të Tahir Maxhunit duhet të jetë Berat Maloku.

9. Shqyrtimi i Kërkesës për harmonizimin e listës së subvencioneve.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me kërkesën në fjalë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - tha se është e nevojshme që Rregullorja për ndarjen e Dekoratave të procedohet në Kuvendin e komunës për ta limituar numrin e titujve që ndahen, e të cilët kanë implikime buxhetore.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 26 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim nga kategoria “subvencione” rubrika “kulturë” nga shuma e përgjithshme njëzetënjë mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë euro (29,375.00 €) merret (hiqet) shuma prej pesë mijë euro (5.000 €).

Shuma e përmendur në këtë vendim ndahet për dhënien e të hollave nga një mijë euro (1.000 €) në rastin e ndarjes së titullit “Nderi i qytetit” për secilin nga këto raste:

Safet Ajeti;

Ilaz Kolla;

Aziz Bici;

Qazim Uka.

10. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i propozimit nga LDK-ja për anëtar të Komitetit për Komunitete.

Agron Perquku, anëtar i kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të LDK-së propozoi Selvete Shollën për anëtare të Komitetit për Komunitete.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi 01Nr.23/14, dt.30.01.2014 për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete me sa vijon:

Emërohet anëtare e Komitetit për Komunitete Selvete Sholla në vend të Fatime Hazirit.

b. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - kërkoi nga organet komunale që të formohet një komision që në mënyrë permanente të përcjellë gjendjen e rrugëve në Komunën e Vushtrrisë, pasi që rrugët e sapondërtuara po dëmtohen shumë shpejt nga peshat e rënda.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar rekrutimit të të rinjve për procesin e regjistrimit të bujqësisë në Komunën e Vushtrrisë, tha se shumë të rinj kanë paraqitur shqetësimet e tyre lidhur me përzgjedhjen, prandaj kërkoi raport me shkrim (brenda 10

ditëve) nga DEBZHR-ja për kriteret e vlerësimit, listën e aplikantëve dhe nivelin e shkollimit të atyre që janë pranuar, sepse ka të rinj të arsimuar në bujqësi, e që nuk janë pranuar.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - pyeti lidhur me kërkesën që e ka bërë në mbledhjen e kaluar të KK-së lidhur me shqetësimin e qytetarëve, pasi që nga reshjet e fundit është prishur rruga Gllavotin-Beçuk, e cila në çdo moment paraqet rrezik potencial për humbjen e jetës së ndonjë qytetari, kështu që kërkoi që të ndërmerren masa urgjente për rregullimin e rrugës në fjalë, prandaj pyeti përsëri se kur do të merret ekzekutivi me këtë çështje.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të LDK-së kërkoi që Kuvendi i komunës të dënojë dhunën ndaj institucionit të komunës, gjegjësisht ndaj zyrtarit komunal Mexhit Hasanit, duke shtuar se kjo nuk është hera e parë që po ndodh.


Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit - kërkoi informatë lidhur me peticionin e paraqitur nga banorët e fshatit Stanoc dhe Lumadh, dhe njëkohësisht kërkoi raport për pengesat që po bëhen në rrugën e cila është pronë komunale.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - sqaroi se Draft-statuti për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, është proceduar në Kuvend duke respektuar ligjin, pasi që i ka kaluar të gjitha fazat e nevojshme për t'u shqyrtuar dhe aprovuar në këtë mbledhje të Kuvendit të komunës, ku pas shqyrtimit të parë në Kuvendin e komunës është proceduar me vota unanime për diskutim publik, dhe kjo dëshmon se nuk ka pasur asnjë shkelje ligjore me procedimin e draft-statutit në fjalë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - duke iu referuar pyetjeve të anëtarëve të kuvendit, u përgjigj me sa vijon: tha se është e nevojshme të gjendet mënyra që çdo kompani që dëmton rrugët me mbipeshë t'i rregullojë ato rrugë, duke shtuar se komuna është duke e aplikuar një strategji të tillë; premtoi se do të merren masa konkrete për rregullimin e rrugës Gllavotin-Beçuk; sulmi ndaj zyrtarit të komunës është sulm ndaj tërë personelit të komunës dhe është propozim i mirë që anëtarët e Kuvendit të komunës të reagojnë për këtë sulm; peticionin e banorëve të fshatrave Stanoc dhe Lumadh, Komuna e ka proceduar për në Ministrinë e Infrastrukturës, duke shtuar se ai rast nuk ndërlihet me projektet e komunës.

Mbledhja përfundoi në orën 13:55.

Albanez Tahiraj



Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit